

**AKT THEMELIMI**  
**i Shoqërisë "Lucror Financial Services" Sh.p.k.**

Sot, me datë 01/03/2021,

- **Wealthy Bee Sh.p.k.**, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me NUIS M11426012T, me seli në: Rruga "Gjin Bue Shpata", Nr. Paurie 1/181/ND+N3, kati 2 (pranë ish-urgjencës), Tiranë, Shqipëri, përfaqësuar nga Administratori Z. Erdi Sakej.

- **Z. Petraq Milo**, shtetas shqiptar, atësia Arkile, lindur në Tiranë, më 07/04/1958, banues në Rruga "Marko Boçari", Pallati SARA-EL, Hyrja 3, Nr. 19, Tiranë, e mbajtës i Kartës së Identitetit me nr. F804071290, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar;

- **Z. Akil Kraja**, shtetas shqiptar, atësia Kujtim, lindur në Durrës, më 22/04/1985, banues në Rruga "Komuna e Parisit", Sheshi "Gjenerali Jozef San Martin", Nd.3, H.6, Ap.33, Tiranë, mbajtës i Kartës së Identitetit me nr. I50422065K, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar;

Në përputhje me ligjin 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare" (i ndryshuar) dhe ligjit nr. 9723, dt. 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", kanë vendosur të themelojnë një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emërtuar "Lucror Finacial Services" Sh.p.k. (më poshtë referuar si "Shoqëria").

**NENI 1**  
**EMËRTIMI**

Emri i Shoqërisë është "Lucror Finacial Services" Sh.p.k.

**NENI 2**  
**SELIA**

Selia zyrtare e Shoqërisë ndodhet në adresën: Rruga "Gjin Bue Shpata", Nr. Paurie 1/181/ND+N3, kati 2 (pranë ish-urgjencës), Tiranë, Shqipëri.

Shoqëria mund të çelë degë dhe/ose zyra përfaqësimi brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë, si dhe të transferojë selinë e shoqërisë në një adresë apo qytet tjeter.

**NENI 3**  
**KOHËZGJATJA**

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një afat të pacaktuar, përvèç zgjatjes ose prishjes së mëparshme të saj sipas vendimit të Asamblesë së Ortakëve.

**NENI 4**  
**OBJEKTI**

Shoqëria ka për objekt të veprimtarisë:

*Akil Kraja*



- 1) Shërbimet që mundësojnë derdhjen, transferimin apo tërheqjen e parave fizike, nëpërmjet një llogarie pagese, si dhe të gjitha veprimet e nevojshme për funksionimin e një llogarie të tillë.
- 2) Shërbimet që mundësojnë derdhjen, transferimin apo tërheqjen, e parave fizike ose jo, nëpërmjet llogarive apo kanaleve elektronike si faqet web/aplikacionet e dedikuara etj., si dhe të gjitha veprimet e nevojshme për funksionimin e një llogarie të tillë.
- 3) Ekzekutimi i transaksioneve të pagesave, duke përfshirë transferimet e fondevës në një llogari pagesash të çelur pranë ofruesit të shërbimit të pagesave të përdoruesit ose pranë një ofruesi tjetër të shërbimit të pagesave:
  - a) ekzekutimi i debitimeve të drejtëpërdrejta, duke përfshirë dhe debitimet e drejtëpërdrejta që bëhen vetëm një herë;
  - b) ekzekutimi i transaksioneve të pagesave përmes një karte pagese ose nga një pajisje e ngjashme;
  - c) ekzekutimi i transfertave të kreditit, duke përfshirë urdhër pagesat periodike.
- 4) Ekzekutimi i transaksioneve të pagesave, ku fonda janë të mbuluara nga një linjë kredie për një përdorues të shërbimit të pagesave:
  - a) ekzekutimi i debitimeve të drejtëpërdrejta, duke përfshirë debitimet e drejtëpërdrejta që bëhen vetëm një here;
  - b) ekzekutimi i transaksioneve të pagesave përmes një kartë pagese / pajisje e ngjashme ose prodhimi/promovimi i tyre;
  - c) ekzekutimi i transfertave të kreditit, duke përfshirë pagesat periodike.
- 5) Lëshimi i një instrumenti pagese dhe/ose pranimi i transaksioneve të pagesave.
- 6) Dërgesat e parave, brënda apo jashtë vendit.
- 7) Shërbimi i inicimit të pagesës.
- 8) Shërbimi i informimit mbi llogarinë e pagesës së një klienti, apo mbi llogaritë dhe transaksionet që klienti mund të ketë hapur apo kryer me palë të treta (shërbime, utilitarë etj.).
- 9) Shërbimi i trajtimit të dhënave, duke përfshire aksesimin, përpunimin, konsolidimin dhe komunikimin mbi këto dhëna.
- 10) Shërbimi i ndërmjetësimit të biznesit, ofrimit të studimeve të tregut, të analizave ligjore, financiare dhe ekonomike.

Shoqëria mund të kryejë gjithashtu të gjitha operacionet tregtare, mbi pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, operacione financiare, industriale, që do të vlerësohen të nevojshme apo të dobishme për realizimin e objektit të shoqërisë si dhe të blejë pjesëmarrje në kapitalin themeltar të shoqërive të tjera që kanë objekt të njëjtë, të ngjashëm apo që lidhet me të vetin.

Shoqëria në ushtrimin e aktivitetit të saj, do të marrë të gjitha autorizimet apo leje, licenca të nevojshme pranë institucioneve publike shqiptare, dhe do të mbështetet në rregullat dhe normat në fuqi në lidhje me ushtrimin e veprimtarisë së saj të rregullt ekonomike.

## NENI 5 KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar është i përbërë nga kontributet në të holla të ortakëve themelues në vlerën 3.500.000 Lekë (tre milion e pesëqind mijë) dhe është i ndarë në 3 kuota.

Kapitali themeltar ndahet si më poshtë:



A handwritten signature in black ink, appearing to read "Abd Krasniqi". To the right of the signature is a stylized, cursive graphic element consisting of several intersecting curved lines forming a shape resembling a stylized letter 'G' or a signature mark.

- **Wealthy Bee Sh.p.k.**, zotëron 1 kuotë, me 51% të kapitalit themeltar, me 1 (një) pjesë me vlerë 1.785.000 (një milion e shtatëqind e tetëdhjetë e pesëmijë) Lekë dhe 1.785.000 (një milion e shtatëqind e tetëdhjetë e pesëmijë) Lekë të kapitalit themeltar.
- **Z. Petraq Milo**, zotëron 1 kuotë, me 30% të kapitalit themeltar, me 1 (një) pjesë me vlerë 1.050.000 (një milion e pesëdhjetë mijë) Lekë dhe 1.050.000 (një milion e pesëdhjetë mijë) Lekë të kapitalit themeltar.
- **Z. Akil Kraja**, zotëron 1 kuotë, me 19% të kapitalit themeltar, me 1 (një) pjesë me vlerë 665.000 (gjashtëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë) Lekë dhe 665.000 (gjashtëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë) Lekë të kapitalit themeltar.

Kapitali themeltar mund të zmadhohet nëpërmjet kontributeve të reja në para ose në natyrë, sipas vendimeve të asamblesë së ortakëve të marra me shumicat të parashikuara për ndryshimin e këtij statuti.

#### NENI 6 ORGANET E SHOQËRISË

Organet e shoqërisë përbëhen nga Asambleja e ortakëve dhe Administratori/ët.

- Asambleja e ortakëve është organi vendimmarrës i shoqërisë e cila vepron në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.
- Asambleja e Përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. **Z. Elton Belba**, shtetas shqiptar, lindur e banues në Tiranë, më 16/06/1975, mbajtës i dokumentit Kartë Identiteti me nr. Personal H50616160U, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, emërohet Administrator i shoqërisë, i cili zgjidhet për një periudhë prej 5 (pesë) vjet, me të drejtë rizgjedhjeje.

#### NENI 7 LEGJISLACIONI I APLIKUESHËM

Aktiviteti i shoqërisë do të rregullohet nga dispozitat e statutit të shoqërisë, si dhe nga të gjitha dispozitat ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

#### NENI 8 DISPOZITA FINALE

Ky Akt Themelimi hartohet në 4 (katër) kopje originale në gjuhën shqipe.

Permbajtja e Aktit të Themelimit u lexua dhe nënshkrua nga Ortakët themelues të shoqërisë duke autorizuar **Administratorin Z. Elton Belba** për të kryer të gjitha veprimet e nevojshme për regjistrimin e shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) në Tiranë.

#### ORTAKËT THEMELUES

AKIL KRAJA

Akil Kraja

PETRAQ MILO

Petraq Milo

Wealthy Bee Sh.p.k.  
Përfaqësuar nga  
ERDI SAKEJ

Erdi Sakej